



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 562/6 prot.

Tiranë më 30.7.2020

REKOMANDIM

Nr. 18, datë 30.7.2020

PËR KONTROLLUESIN "BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD –
DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji"), ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim, "Kodi i Procedurave Administrative"), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Bankers Petroleum Albania LTD - Degë e Shoqërisë së Huaj" (në vijim, "Kontrolluesi"),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 93, datë 10.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

➤ Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga z.
në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit, vëren se:

1. Kontrolluesi ka si objekt të veprimtarisë tregtare, ndër të tjera, kryerjen e operacioneve hidrokarbure në zonat e miratuara në marrëveshjet hidrokarbure, ndërtimin dhe montimin e të gjitha mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në operacionet hidrokarbure, etj.
2. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, nr. 562 prot., datë 21.05.2020, Zyra e Komisionerit i është drejtuar, paraprakisht, Kontrolluesit me shkresën nr. 562/1 prot., datë 27.05.2020, duke kërkuar informacion

dhe sqarime në lidhje me pretendimet e ankuesit dhe veprimet e ndërmarra në raport me kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, në zbatim të nenit 6 të Ligjit.

Kontrolluesi, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 457/1 prot., datë 10.06.2020, bashkëlidhur së cilës ka vendosur edhe provat për argumentimin e parashtrimeve.

Nga verifikimi i kryer dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, u konstatua se, më datë 11.04.2020, punëmarrësve ju është dërguar një e-mail nga ana e Menaxherit të Departamentit IT, lidhur me politikat e përdorimit të kompjuterit dhe e-mailit të punës dhe udhëzime të IT, si dhe një dokument (fotografi), në formatin “.jpg” (objekt i ankesës). Ky dokument, në formatin “.jpg”, me përmbajtje të natyrës seksuale, rezultoi t’i jetë dërguar, nga ankuesi (tashmë, ish punëmarrës i Kontrolluesit), nëpërmjet e-mailit zyrtar, në adresë të disa punëmarrësve të tjerë të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përhapja dhe publikimi i të dhënave personale dhe sensitive të ankuesit, nga ana e Departamentit IT të Kontrolluesit, drejt punëmarrësve të tjerë të paautorizuar, është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (pasi tejkalohet qëllimi i përpunimit të të dhënave dhe, për pasojë, përpunimi nuk është i drejtë dhe i ligjshëm), kriteret ligjore të përpunimit dhe detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale, parashikuar në nenet 5, 6, 7 dhe 28 të Ligjit.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë veprimtarisë tregtare, u konstatua se Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “kandidatë për punë”, “punëmarrës”, “familjarë të punëmarrësve” dhe “punëmarrës të larguar”. Të dhënat personale përpunohen manualisht në “Dosjen personale të punëmarrësit” dhe nëpërmjet mjeteve elektronike (aplikacion i burimeve njerëzore).
4. Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat për kohën e ruajtjes së të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punonjës të larguar” dhe “kandidatë për punë”, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionuar në gjuhën “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar të dhënat personale. Në momentin kur qëllimi i përpunimit ka përfunduar është e nevojshme që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një palë e tretë në cilësinë e përpunuesit, të realizojë shkatërrimin/fshirjen e të dhënave personale, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

5. Kontrolluesi nuk ka vendosur "*Politika privatësie*" në faqen zyrtare të internetit <https://bankerspetroleum.com/>, në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2012, të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*" (në vijim, "*Vendimi nr. 6*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin të publikojë "*Politikat e Privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i "*Politikave të Privatësisë*" përmbush më së miri qëllimin e informimit.

6. Në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, Kontrolluesi ka instaluar një sistem video survejimi (CCTV). Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese për prezencën e sistemit të video survejimit, por konstatohet se ato nuk përmbajnë elementët e nevojshëm për informimin e subjekteve në lidhje me përpunimin e të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 mbi "*Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 3*") dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 "*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 11*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre njohjen me të drejtat që iu janë akorduar në Kushtetutë dhe Ligj, si dhe ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

7. Kontrolluesi ka lidhur një kontratë shërbimi me objekt "*Sigurim shëndeti në grup*", me shoqërinë "*Sigal Uniq Group Austria*" SHA (në cilësinë e përpunuesit). Konstatohet se në këtë kontratë nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 19*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave. Detyrimet e Përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19.

8. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- i. Deklarimin në rubrikën , *“Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”*, të tilla si *“kandidatë për punë”*, *“vizitorë”*, etj.;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4 *“Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”*, të tilla si *“imazhe nëpërmjet kamerave të sistemit CCTV”*, *“fotografi të punëmarrësve”*;
- iii. Deklarimin në rubrikën 6 *“Qëllimi i përpunimit”*;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7 *“Marrësi i të dhënave personale”*, subjekte drejt të cilëve Kontrolluesi i përhap të dhënat, në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit/delegimit të përpunimit, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të Kontrolluesit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

9. Kontrolluesi nuk disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave (*të punëmarrësve, punonjësve të larguar, kandidatëve për punë dhe vizitorëve*), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një rregulloreje të posaçme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

10. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr.47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës dhe, në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur pretendimet me shkrim, për shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Sa i përket pretendimeve të Kontrolluesit se emaili i dërguar nuk përmban asnjë të dhënë personale të ankuesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni dhe të dhënat e publikuara nëpërmjet komunikimit në e-mail, nisur nga natyra seksuale e përmbajtjes që identifikon sjellje dhe preferenca të caktuara që lidhen ngushtësisht me ankuesin, konsiderohen të dhëna personale dhe sensitive në kuptim të nenit 3 të Ligjit.

Pavarësisht pretendimeve se e-maili është pronë e Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për këtë fakt, Kontrolluesi legjitimohet të përpunojë dhe administrojë të dhënat e përdoruesve të e-mailit, në kuadër të marrëdhënies përkatëse të punës dhe/ose shërbimit, por, nga ana tjetër, se përhapja e të dhënave personale (sidomos atyre

sensitive), në adresë të subjekteve të tjera të të dhënave, përbën tejkalim të qëllimit të përpunimit të të dhënave.

Sa i përket pretendimeve të Kontrolluesit se objekti i hetimit administrativ ishte vetëm verifikimi i ankesës, Zyra e Komisionerit sqaron se në Urdhrin nr. 93, datë 10.06.2020, të nxjerrë për hetimin administrativ të Kontrolluesit, është përcaktuar qartë se objekti i hetimit administrativ pranë këtij të fundit është verifikimi i ankesës së subjektit të të dhënave personale, si dhe zbatimi i Ligjit. Në këtë rast, ashtu si edhe në raste të tjera të ngjashme, me qëllim verifikimin në tërësi të respektimit të parimeve, të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në ligj, Zyra e Komisionerit e ka shtrirë objektin e hetimit përtej ankesës.

Sa i përket deklarimeve të Kontrolluesit se teksti i e-mailit të ankuesit përbën vepër penale Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo është jashtë objektit të kompetencave të saj ligjore për tu shprehur për këtë aspekt.

Sa i përket pretendimeve lidhur me afatin e mbajtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se përcaktimi i këtyre afateve nga Kontrolluesi është një detyrim ligjor dhe, për përcaktimin e tij, Kontrolluesi duhet të ketë parasysht edhe afatet e tjera të parashikuara në legjislacionin specifik.

Sa i përket pretendimeve lidhur me kontratën e shërbimit midis Kontrolluesit dhe Përpunuesit "*Sigal Uniqa Group Austria*" SHA, Zyra e Komisionerit vlerëson se neni 29 i kontratës nuk referon detyrimet e palëve në zbatim të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19.

Sa i përket pretendimeve lidhur me hartimin e Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", Zyra e Komisionerit vlerëson se parashikimet në "*politikat e privatësisë*", referuar nga Kontrolluesi, nuk janë të plota, pasi nuk referojnë të gjithë elementet dhe detyrimet ligjore, si dhe në to nuk parashikohen rregulla specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave për çdo kategori subjektsh të të dhënave (*punëmarrësve, punëmarrësve të larguar, kandidatëve për punë dhe vizitorëve*) dhe për çdo proces përpunimi.

Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë dhe bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ, si dhe angazhimin serioz të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 20, 21, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, gërma "a/1"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 5 të Ligjit, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit në lidhje me shkelje të kësaj dispozite. Për këtë arsye, Kontrolluesi të parashikojë afate konkrete për ruajtjen e të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të dhënat personale të të cilëve ai përpunon sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit. Për këto afate të informohen edhe subjektet e të dhënave;
2. Kontrolluesi të fshijë të dhënat personale dhe sensitive objekt ankimi, pavarësisht formës dhe mënyrës së përpunimit të tyre, duke garantuar mospërhapjen e tyre. Gjithashtu, të fshihen/shkatërrohen të dhënat e mbledhura për kategoritë e subjekteve të të dhënave, të cilat përpunohen në kundërshtim me nenin 5 dhe 6 të Ligjit.
3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit të *“Politikave të Privatësisë”* në faqen e internetit dhe për vendosjen e tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit sipas standardit të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të miratuar nga Komisioneri;
4. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjen me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të miratuar nga Komisioneri;
5. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje të vazhdueshme përditësimin e *“njoftimit”* në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë një rregullore të posaçme, në të cilën të parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e stafit të tij, si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës “b” të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

8. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
- (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikën 2 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 1, 3, dhe 4 më sipër; dhe
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuara në pikën 6.
9. Kontrolluesi “*Bankers Petroleum Albania LTD - Degë e Shoqërisë së Huaj*” të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 30.7 .2020

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

